

FIER, SI U SHPARTALLUA MAFIA E NAFTËS

Gentjan Ruko
"Koha Jonë", 16 shtator 2001

FIER - Goditet ashpër mafia e naftës. Sërish policia e Fierit zbulon tonelata të tëra nafte shtetërore të vjedhur. Kjo ndodhi dje në mëngjes, kur uniformat blu ndërmorën një blitz mbi një stacion të improvizuar të trafikimit të arit të zi. Për pasojë, dy vëllezër përfunduan në pranga. Shkëlqim Xhafa dhe Altin Xhafa u arrestuan në flagrancë, në shtëpinë e tyre, në fshatin Kallm të Fierit, ndërsa bashkëpunëtorë të tyre janë shpallur persona në kërkim.

Fare pranë vilës së tyre, ata kishin ngritur një baxho për të mbuluar gjurmët e vjedhjes. Aktiviteti i tyre kryesor, ai më fitimprurësi, ishte tregtia e naftës së vjedhur. Ata ishin maskuar duke pretenduar se rezervat e mëdha të naftës, që kishin grumbulluar në vaska të mbyllura pranë baxhos, u nevojiteshin si lëndë djegëse për punishten e qumështit. Por, Xhavit Shala, drejtori i policisë së Fierit, sqaron se punishtja konsumon çdo ditë jo më shumë se 100 litra solar (naftë e papërpunuar), ndërkohë që policia, dje, kapi në flagrancë dhe sekuestroi 4 mijë litra solar, natyrisht të përgatitur për tu shitur. Nafta mbahej në 9 fuçi me 200 litra secila, ndërkohë që pjesën tjetër të naftës e kishin futur në një depozitë të madhe të qëndrueshme.

Solari vidhej në pusët e naftës, që i takojnë sektorit nr.4 të Ndërmarrjes së Nxjerrjes së Naftës Marinëz, e që ndodhet afër baxhos. Fuçitë mbusheshin rrafsh dhe transportoheshin me barkë nga njëri breg i lumit Seman në tjetrin, ndonëse lumi kishte shteruar aq sa mund të kalohej edhe në këmbë. Policia sulmoi pikërisht në një rast të kalimit të fuçive nëpër lumë dhe arriti të fiksojë në celuloid një moment të tillë, siç duket edhe në foto. Nafta e papërpunuar përzihet me serë për t'iu shitur më pas, si lëndë djegëse, furrave të bukës në atë zonë.

Historia

Për herë të parë pas një dekade, policia e Fierit nis kështu një fushatë për të ndëshkuar vjedhësit e naftës, pikërisht ata që janë pasuruar për vite të tëra me një nga trafiqet më fitimprurës. Ndërhyrjet e policisë lokale ndodhën pasi Kryeministri Meta urdhëroi goditjen pa mëshirë të korrupsionit të madh ku është zhytur industria e naftës, në një konferencë rajonale, zhvilluar në muajin maj në Fier. Kryeministri kritikoi ashpër drejtuesit e kompanisë "Albpetrol" dhe vlerësoi punën e forcave të rendit, që kishin filluar atëherë të shfaqnin shenja ngritjeje. Xhavit Shala shpjegon se nafta vidhet në bashkëpunim me punonjës të ndërmarrjeve shtetërore që nxjerrin dhe transportojnë naftën, por gishti i inspektorëve antitrafik të policisë nuk është ndalur ende mbi ndonjë drejtor filiali të "Albpetrol"-it të dyshuar se është implikuar. Punëtorët u kallëzojnë hajdutëve se ku ndodhen tubacionet e naftës dhe oraret kur ajo transportohet për në depozita. Shala thotë se këtë vit, në 8 episode vjedhesh të naftës, 16 autorë janë kapur në flagrancë. Por, organet e drejtësisë gati i kanë nëpërkëmbur rezultatet e luftës antitrafik për të cilën është angazhuar qeveria: dënimi më i rëndë i dhënë

nga gjykata nuk i kalon 3 muaj burg. I pari i arrestuar për vjedhje të naftës është Lulëzim Toska nga Ballshi. U kap me një sasi benzine të vjedhur në Kombinatin e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh, më 4 maj. Por, prokuroria e liroi, pasi pushoi çështjen penale të ngritur kundër tij, duke i dhënë fund kështu ditëve të arrestit pa afat për të arrestuarin në flagrancë.

Më 23 maj, policia zbuloi 3,8 tonë solar të vjedhur dhe që ishte ngarkuar në autobot. Në vend që ta shpinin në destinacion, dy punonjës të ndërmarrjes shtetërore, Dane Rama dhe Riza Agalliu, e shisnin naftën për llogari të tyre. Gjykata e Fierit e dënoi Ramën me 3 muaj heqje lirie, ndërkohë që liroi Agalliu.

Më 8 qershor, policia zbuloi një nga vjedhjet më të mëdha. Plot 12 mijë litra naftë u gjetën dhe u konfiskuan në një depozitë të nëndheshme, në oborrin e një shtëpie, që ndodhej buzë përroit të Gjanicës, në hyrje të qytetit të Fierit. Disa metra larg depozitës, ishin parkuar edhe 3 bote të zbrazur me kapacitet 2 mijë litra naftë secili. Tre vjedhësit, Altin Rama, Gazmend Serjani dhe Gjergji Profka, arritën të largoheshin mes territ të natës, kur dalluan të afrohej policia. Të tre, ata janë shpallur persona në kërkim. Ata e vidhnin naftën në pusët që ndodheshin disa km larg shtëpisë. Ata e transportonin me anë të një karroce ku kishin përshtatur një pajisje metalike mbajtëse me nxënësi 1 mijë litra.

Rasti i katërt u konstatua më 18 qershor. Ashtu si vëllezërit Xhafa, Remzi Kodheli dhe vjehri i tij, Mehmet Nazëraj, në Visokë të Mallakastrës, vidhnin naftë nga vendburimi dhe e maskonin vjedhjen nëpërmjet baxhos së tyre. U arrestuan në flagrancë me dy fuçi 200 litërshe secila. Gjykata e dënoi Kodhelin me muaj burg, ndërsa Nazërajn vetëm me 1 muaj e gjysmë.

Më 8 qershor, u zbulua e para vjedhje e nëndheshme e naftës. Nuri Rexha, president i një firme me të njëjtin emër, i licencuar për tregti të karburanteve, u arrestua për vjedhje të pasurisë shtetërore në përmasa të mëdha. Territori i firmës së tij në Ballsh ndodhej fare afër Kombinatis të Naftës dhe ai kishte lidhur një tub të nëndheshëm me tubacionin kryesor që transportonte çdo dy ditë 100 mijë litra naftë nga Kombinati në drejtim të puseve të naftës. Bëhet fjalë për një vjedhje sistematike dhe ku autobote të panumërt mbusheshin lehtësisht sikur të ishte ujë. 33-vjeçari Rexha, ndodhet i arrestuar në dhomat e paraburgimit.

Ndërkaq, më 17 gusht, në qytezën e Roskovecit, u zbulua një furgon që udhëtonte me 34 bidona të ngarkuar me 900 litra naftë të vjedhur në Kombinatin e Naftës në Ballsh. Për të realizuar vjedhjen, 3 personat e arrestuar në flagrancë kishin shfrytëzuar afërsinë e shtëpive të tyre me kombinatin. Vetëm për njërin prej tyre, Dashnor Sulo, gjykata e Fierit vendosi të qëndronte në burg deri në përfundim të hetimeve, ndërsa liroi dy bashkëpunëtorët e tij, Besnik Llanaj dhe Islam Hoxha.

Së fundi, zbulimi i të dytës vjedhje të nëndheshme të naftës ndodhi një javë më parë, afër Patosit. Sulejman Shkodra, pronar i një fabrike tullash në Kavajë dhe Shefqet Kasa, president i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, i pajisur me leje për tregti karburantesh, u prangosën për vjedhje në bashkëpunim. Ndërkohë që

policia ka shpallur persona në kërkim dy të tjerë, të quajtur Berti Sholla dhe Luan Bakiasi. Ata kishin çarë në dy pika tubacionin kryesor të transportimit të naftës, nga rafineria e Fierit drejt Kombinatit të Naftës në Ballsh. Kur policia mbërriti në vendngjarje, në orën 1 pas mesnate, Sholla dhe Bakiasi u larguan me vrap nëpër errësirë. Por, ata lanë pas provën e krimit të konsumuar: autobotin me targë KJ 1812 A të sapombushur me naftën e vjedhur; dhe nuk patën kohë që ta shkëpusnin tubin që zgjatej nga rezervuari i makinës deri te tubacioni i naftës.


Speciale

Shkëqim Xhafa dhe Altin Xhafa u arrestuan në flagrancë, në shtëpinë e tyre, në fshatin Kallm të Fierit, ndërsa bashkëpunëtorë të tyre janë shpallur persona në kërkim. Fare pranë vllës së tyre, ata kishin ngritur një baxho për të mbuluar gjurmët e vjedhjes



Fier, si u mafia

Vazhdon të rritet numri i të arrestuarëve të policisë në urdhër të lëshuar nga kryeministri Meta pak ditë më parë. Të gjitha rastet kur janë arrestuar pronarë e punëtorë orgjinale. Por edhe ato çështje penale që kanë degr...



Kryeministri kritikoi ashpër drejtuesit e kompanisë "Alpgetrol", por vlerësoi punën e forcave të rendit, që sapo kishin filluar atëherë të shfaqnin shenja ngriëje. Xhafa Shala shpjegon se nafta vjedhet në bashkëpunim me punonjësit të ndërmarrjeve shtetërore që nxjerrin dhe transportojnë naftën, por gjithë i inspektorëve antitrafik të policisë nuk është ndalur ende mbi ndonjë drejtor filiali të "Alpgetrol"-it të dyshuar se është implikuar.

Speciale

shpartallua e naftës

r llogari të vjedhjes së naftës. Gjithëcka lidhet me një parë por edhe me forcën goditëse të uniformave blu. ë firmash që kanë vjedhur arin e zi me mënyra kref duar apo që janë shoqëruar me dy tre muaj burg

Shala thotë se këtë vit, në 8 episode vjedhesh të naftës, 16 autorë janë kapur në flagrancë. Por, organet e drejtësisë gati i kanë nëpërkëmbur rezultatet e luftës antitrafik për të cilën është angazhuar qeveria: dënimi më i rëndë i dhënë nga gjykatat nuk i kalon 3 muaj burg.



Shefqet Kasa, i arrestuar më 10 shtator, president i firmës "Kasa" e licencuar për tregji karburantesh





30t i nëndheshëm i zbuluar në 8 qershor në oborrin e një shtëpie buzë përroit të Gjanicës në Fier. Aty grumbullohet tafta e transportuar me karroca nga pusët për tu shitur më pas furrave të bukës si lëndë djegëse.

ortestuarin në flagrancë. Më 23 maj, solica zbuloi 3.8 tonë solar të vjedhur dhe që ishte ngarkuar në autobus. Në fund që ta shpinin në destinacion, dy anonjës të ndërtuarjes shtetërore. Dane Rama dhe Riza Agalliu, e shinin ushtën për llogaritë të tyre. Gjykata e Fierit e dënoi Ramën me 3 muaj heqje lirie, ndërkohë që lirori Agalliu. Më 8 qershor, policia zbuloi një nga vjedhjet më të mëdha. Pasi 12 mijë litra naftë u gjetën dhe u konfiskuan, në një depo të ndërtuar në oborrin e një shtëpie, që uodulaj buzë përroit të Gjanicës, në hyje të qytetit të Fierit. Disa metra larg lepozitës, ishin parkuar edhe 3 bote të bratur me kapacitet 2 mijë litra naftë ecili. Tre vjedhësit, Altin Rama, Gazmend Serjani dhe Gjergji Profta, arriën të largoheshin mes territ të natës, kur lalluan të afrohet policia. Të tre, ata janë hapullur persona në kërkim. Ata e idhnin naftën në pusët që ndodheshin lisa km larg shtëpisë. Ata e transportuan me anë të një karroce ku kishin rështatur një pajisje metalike mbajtëse në oxhënsi 1 mijë litra. Rasë i kuzur u snastua më 18 qershor. Ashtu si ellezërit Xhafa, Remzi Kodhelit dhe vje-

hriti i tij, Melumel Nazëraj, në Visokë të Mallakastërës, vidhën naftë nga vendburimi dhe e maskonin vjedhjen nëpërmjet baxhos së tyre. U arrestuan në flagrancë me dy luçi 200 litërshë secila. Gjykata e dënoi Kodhelin me muaj burg, ndërsa Nazërajn vetëm me 1 muaj e gjysmë. Më 8 qershor, u zbulua e para vjedhje e nëndheshme e naftës. Nuri Rexha, president i një firme më të njëjtin emër, i licencuar për tregti të karburanteve, u arrestua për vjedhje të pasurisë shtetërore në përmasa të mëdha. Territori i firmës së tij në Ballsh uodohaj fare afër Kombinait të Naftës dhe ai kishte lidhur një tub të nëndheshëm me tubacionin kryesor që transportonte çdo dy ditë 100 mijë litra naftë nga Kombinai në drejtim të puseve të naftës. Bëhet fjalë për një vjedhje sistematike dhe ku autobote të pasumërit tubeshin lehtësisht sikur të ishte ujë. 33-vjeçari Rexha, ndodhet i arrestuar në dhomat e parburgimit. Ndërkaq, më 17 gusht, në qytetin e Raskovecit, u zbulua një furgon që udhëtonte me 34 bidona të ngarkuar me 900 litra naftë të vjedhur në Kombinatin e Naftës në Ballsh. Për të realizuar vjedhjen, 3 personat e arrestuar në flagrancë

kishin shfrytëzuar afërsinë e shtëpisë të tyre me kombinatin. Vetën për ajëru prej tyre, Dashuor Sulo, gjykata e Fierit vendosi të qëndronte në burg deri në përfundim të hetimeve, ndërsa lirori dy bashkëpunëtorët e tij, Besnik Llazaj dhe Islam Hoxha. Së fundi, zbulimi i të dytës vjedhje të nëndheshme të naftës uoduli një javë më parë, afër Patosit. Sulejman Shkodra, prokuror i një fabrike tullash në Kavajë dhe Shefqet Kasa, president i një shoqënie me përgjegjësi të kurizuar, i pajisur me leje për tregti karburantesh, u pranësën për vjedhje në bashkëpunim. Ndërkohë që policia ka shpallur persona në kërkim dy të tjerë, të quajtur Berti Sholla dhe Luan Bakia. Ata kishin çarë në dy pila tubacionin kryesor të transportimit të naftës, nga rafineria e Fierit drejt Kombinait të Naftës në Ballsh. Kur policia mbërriti në vendngjarje, në orën 1 pas mesnate, Sholla dhe Bakia: u larguan me vrap nëpër errësirë. Por, ata lanë pas provën e krimin të konsumuar: autobotin me targë KJ 1812.A të sapom-bushur me naftën e vjedhur; dhe nuk patën kohë që ta shikëpunin tubin që zgjatet nga rezervuari i makinës deri te tubacioni i naftës.



Berti Sholla, person në kërkim, bashkëpunëtor i Shefqet Kasës



Luan Bakia, person në kërkim, anëtar i grupit të Shefqet Kasës